



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË

Viti mësimor 2016-2017

Faza e dytë

Klasa 12

Model përgjigjesh të sakta

Pyetja 1

a) **2 pikë**

- Papunësia në vendin e ri;
- Racizmi;
- Pengesat gjuhësore;
- Mundësitë e pakta, etj

Shënim: Nxënësi duhet të shkruajë të paktën dy nga të mësipërmet për të marrë pikët e plota.

b) **2 pikë**

Disavantazhet

- Zvogëlohet fuqia punëtore, duke qenë se emigrimi përfshin njerëz që janë në moshën e punës.
- Prishet raporti gjinor. Meshkujt janë ata që përfshihen në procesin e emigrimit.
- Largimi i “trurit”. Emigrimi prek edhe njerëz të kualifikuar.

Shënim: Nxënësi duhet të shkruajë të paktën dy nga të mësipërmet për të marrë pikët e plota.

c)

Kanadaja është një vend shumë i zhvilluar dhe ka nevojë për punëtorë jo shumë të kualifikuar **2 pikë**

Gjermania është një vend me popullsi në plakje dhe ka nevojë për të gjithë llojet e punëtorëve **2 pikë**

Kuvajti edhe pse një vend i vogël, i pasur dhe pak i populluar ka nevojë për punëtorë të industrisë së naftës. **2 pikë**

Pyetja 2

a) **2 pikë**

- Erërat e qarkullimit të përgjithshëm **1 pikë**
- Dendësia e ujërave **1 pikë**
- Ndryshimi i nivelit të ujërave **1 pikë**

Shënim: Nxënësi duhet të shkruajë të paktën dy nga të mësipërmet për të marrë pikët e plota.

b) **4 pikë**

Efekt i Koriolosit për shkak të rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet, bën të mundur shmangien e rrymave djathtas për Hemisferën Veriore dhe majtas për Hemisferën Jugore

Shpërndarja e kontinenteve dhe konfigurimi i tyre bën të mundur devijimin e rrymave oqeanike nga drejtimi i tyre fillestar. Në këtë mënyrë rrymat mund të ndryshojnë drejtim, madje dhe të ndahen, p.sh rryma ekuatoriale Jugore kur takohet me kontinentin e Amerikës së Jugut ndahet në rrymën e Guajanës dhe atë Brazilit.

Pyetja 3

a)

- Pjesa më e madhe e gazeve të atmosferës janë të përqendruar pranë sipërfaqes së Tokës. **1 pikë**
- Për shkak të forcës së rëndesës, gazet tërhiqen drejt sipërfaqes së Tokës, ku arrijnë dendësinë më të madhe. **1 pikë**

b)

Elementet e gazta të atmosferës përbëhen nga azoti, oksigjeni, CO₂, etj.

Azoti ka rëndësi sepse:

1 pikë

- është një nga përbërësit kryesorë të proteinave, molekula themelore për strukturën dhe funksionimin e qelizave të organizmave.
- është substancë ushqimore për bimët
- Parandalon djegien e shpejtë në sipërfaqen e Tokës.

Oksigjeni

1 pikë

- Është gazi kryesor për zhvillimin e jetës në Tokë
- Merr pjesë në procesin e djegies, oksidimit etj.

Dyoksidi i karbonit

1 pikë

- zë një përqindje të vogël, por që pa praninë e tij bimët nuk mund të prodhojnë oksigjenin

Shënim: Nxënësi duhet të shkruajë të paktën një nga rëndësitë e secilit prej elementeve të gazta për të marrë pikët e plota.

Pyetja 4

a) **1 pikë**

Në datën 22 dhjetor

b) **2 pikë**

Në figurën e dytë, ajo që i korrespondon është figura e katërt, sepse në datën 22 dhjetor rrezet e Diellit bien pingul në Tropikun e Jugut.

c) Në Ekuator **1 pikë**

d) Në pikën A **1 pikë**

e) Në pikën E **1 pikë**

Pyetja 5 **4 pikë**

Liqeni Aral ndodhet në kontinentin e Azisë, midis Kazakistanit dhe Uzbekistanit. Ai renditej i katërti në botë për nga sipërfaqja. Sipërfaqja e tij është zvogëluar nga 68 000 km² në 28 000 km². Kjo ka ndodhur për shkak të devijimit të rrjedhjeve të lumenjve që dikur furnizonin me ujë liqenin. Devijimi i lumenjve Amu Darja dhe Sir Darja u bë për të vaditur tokat përreth në mënyrë që të mbilleshin oriz, pambuk etj. Kjo konsiderohet si një nga katastrofat më të mëdha mjedisore në planetin tonë.



Pyetja 6

a) **4 pikë**

- Meridiani i ndërrimit të datave kalon në Oqeanin Paqësor.
- Për shkak të kohës zonale është bërë ndarja e planetit në 24 breza, ku çdo brezi i takon 15° . Si brez fillestar është përcaktuar meridiani i Grinuiçit.
- Gjatë kalimit nga njëri brez në tjetrin drejt lindjes koha zonale është 1 orë para, kurse drejt perëndimit është një orë prapa.
- Në këtë mënyrë në të dyja anët e meridianit 180° do të kemi një ndryshim prej 24 orësh.

b) **1 pikë**

Nëse kalojmë nga Amerika në Azi nëpërmjet Oqeanit Paqësor duhet të shtojmë një ditë.

c) **1 pikë**

Nëse kalojmë nga Azia për në Amerikë nëpërmjet oqeanit Paqësor duhet të përsëritim datën

Pyetja 7

a) **1 pikë**

Ulja e temperaturës me rritjen e lartësisë përbën një dukuri normale në troposferë. Ndërsa inversionet e temperaturës, që do të thotë rritja e temperaturës me rritjen e lartësisë, përbën një shmangie nga gjendja normale e saj.

b)

Inversionet orografike lidhen me ato forma të relievit ku ndodh një zhvendosje e ajrit të ftohtë në pjesët më të ulëta të tij dhe ku lëvizjet turbulente janë të pakta. Shembull tipik është Verhojansku në Siberi, ku temperaturat janë $10-15^{\circ}$ më të ulëta sesa në shpatet e maleve. **2 pikë**

Inversionet advective formohen gjatë lëvizjes horizontale të ajrit të ngrohtë mbi shtresën më të ftohtë të tokës, OSE kur depërton ajri i ngrohtë detar mbi sipërfaqen e ftohtë kontinentale, OSE kur lëviz ajri me temperaturë mbi 0°C në sipërfaqet e mbuluara me borë. **2 pikë**

Pyetja 8 **Totali 8 pikë**

Kriteret e vlerësimit të esesë

Kriteri I: Organizimi dhe struktura e esesë: 2 pikë

Struktura e esesë respekton këto elementë:

- hyrjen - zhvillimin - përfundimin. Nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës; **1 pikë**
- organizimi i esesë - ka një organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri). **1 pikë**

Kriteri II: Analiza: 4 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi shkruan një ese, ku argumenton idetë e tij për temën e dhënë.

- mban qartë një pozicion të dukshëm në argumentet e dhëna; ka qartësi mendimi; **2 pikë**
- përdor shembuj dhe mbështetet në argumente bindëse për përgjigjen e dhënë; **2 pikë**

Kriteri III: Stili e origjinaliteti: 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të qartë për atë që do të shprehë.

- qartësia e të shkruarit të esesë. Duhet të shprehet me një gjuhë të saktë dhe pa huazime; **1 pikë**
- nxënësi duhet t'i përmbahet udhëzimeve që janë parashtruar në temën e esesë. **1 pikë**